

VENDIM
Nr.1036, datë 10.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE MËSIMORË,
NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194 datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
- a) Lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- b) Pika 2/I ndryshohet, si më poshtë vijon:
- “2/I. Paga e grupit, sipas nivelit arsimor të kërkuar nga vendi i punës, është si më poshtë vijon:
- Grupi 1 - 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë. Në këtë grup përfshihen:
- Diplomë e Nivelit të Dytë (DND), Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) (Master i Shkencave ose Master i Arteve të Bukura);
 - Diplomat e mëparshme 3-vjeçare, me titullin “Mësues i ciklit të ulët” dhe “Mësues i ciklit të lartë” të arsimit bazë;
 - Diploma universitare e ciklit të parë DNP (*Bachelor*);
 - Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.
- Grupi 2 - 10 000 (dhjetë mijë) lekë. Në këtë grup përfshihen:
- Diplomë e shkollës së mesme pedagogjike, për të cilat jepet titulli “Mësues i shkollës fillore”;
 - Diplomë e shkollës së mesme profesionale, për të cilat fitohet specialiteti për mësuesi;
 - Diplomë mbi shkollën e mesme. Të tilla konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe diplomat jouniversitare profesionale dyvjeçare.
- Grupi 3 - 8 000 (tetë mijë) lekë. Në këtë grup përfshihen diplomat e shkollës së mesme.”.
2. Efektet financiare për vitin 2010, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për vitin 2010.
3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 dhjetor 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1
STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

	Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
		1	2	3	4
1	Drejtor i shkollës së mesme Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	49000

	Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore Drejtor i konvikteve				
2	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme Përgjegjës i bazës prodhuese Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë Zëvendësdrejtor në shkollat me probleme të larta mendore	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	44000
3	Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	42000
4	Drejtor i shkollës 9-vjeçare	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	40000
5	Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV. Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive Zëvendësdrejtor i shkollës 9-vjeçare	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	37500
6	Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	36000
7	Drejtor i kopshtit me ushqim	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	36000
8	Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	33000
9	Mësues në shkollat e mesme Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë Mësues në shkollat me probleme të larta mendore	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	35000
10	Inspektor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e P.G.		34000
11	Mësues në shkollat 9-vjeçare, klasa I-IX Edukator konvikti Kujdestar konvikti	1 ose 2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	32000
12	Edukator në kopsht fëmijësh	1 ose 2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	29000
13	Mësues	2 ose 3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	26000
14	Edukator në kopsht fëmijësh	2 ose 3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	24500